

ANALIZË:

**(PA)QËNDRUESHMËRIA
FINANCIARE E KOMUNAVE**

**ANALIZË:
(Pa)Qëndrueshmëria financiare e komunave**

Analiza e Planifikimit, inkasimit dhe shpenzimit të të hyrave vetanake të komunave të Republikës së Kosovës

Iniciativa për Progres – **INPO**
Tetor, 2015

Copyright © 2015, Iniciativa për progres - INPO

INPO ka të gjitha të drejtat e rezervuara mbi këtë botim. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo shpërndahet në çfarëdo forme të mundshme pa lejen paraprake me shkrim të botuesit. Qëndrimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi vetëm e botuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen së përfaqësojnë qëndrimet e donatorëve që mbështesin INPO-në.

Kjo analizë u mbështet nga:



RRETH INPO-së

INPO është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e dedikuar që t'i shërbej kauzës së demokracisë, e cila angazhohet për zhvillimin e politikave publike gjithëpërfshirëse. Vizioni i organizatës është që të ngrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike dhe sociale përmes fushatave avokuese dhe senzibilizuese që kanë për qëllim promovimin e parimeve të shoqrisë së hapur, transparencës dhe llogaridhënies gjatë bërjes së politikave publike.

Puna e organizatës është e organizuar përmes tri programeve: Programi për qeverisje të mirë në nivel lokal, Programi për prokurimin publik dhe Programi i të rinjëve. Në kuadër të këtyre tri programeve INPO implementon aktivitete të ndryshme që kryesisht përputhen me misionin “watchdog”. Aktivitetet kryesore të organizatës implementohen në kuadër të programit për qeverisjen e mirë në nivel lokal dhe konsistojnë në monitorimin nga afër dhe sistematik të punës së komunave.

Përmbajtja

I. Hyrja	8
II. Buxheti dhe të hyrat vetanake	10
III. Komuna e Prishtinës	15
Buxheti dhe trendet e të hyrave vetanake	15
IV. Komuna e Ferizajt	18
Buxheti dhe trendet në të hyrat vetanake	19
V. Komuna e Kaçanikut	22
Buxheti dhe trendet në të hyrat vetanake	22
VI. Komuna e Shtimes	25
Buxheti dhe trendet e të hyrave vetanake	26
VII. Komuna e Hanit të Elezit	27
Buxheti dhe trendi i të hyrave vetanake	27
VIII. Përfundimet	29
IX. Rekomandimet	31
A. Për Komunat:	31
B. Për Ministrinë e Financave:	32

I. Hyrja

Për një qeverisje të mirë është shumë e nevojshme menaxhimi efikas i parasë publike. Me këtë, komunat shtrojnë para vetes qëllimet dhe objektivat në të cilat mbështeten në realizimin e kërkesave të qytetarëve për një mirëqenie më të mirë dhe padyshim në përputhje me buxhetin e përcaktuar.

Organizatave buxhetore përfitojnë grante qeveritare duke përfshirë këtu grantin e përgjithshëm, grantin specifik të shëndetësisë, grantin specifik të arsimit dhe të hyrat vetanake dhe në këtë mënyrë mandej do të shfrytëzohen për shpenzime komunale e që marrin pjesë kategoritë ekonomike si: paga dhe medita, mallra dhe shërbime, shpenzime për komunal, subvencione dhe transfere dhe shpenzimet kapitale. E gjithë kjo shpërndarje bëhet përmes qarkoreve buxhetore ku organizatave buxhetore u caktohet buxheti se sa kanë për të shpenzuar për një vit fiskal dhe të gjitha këto udhëzime rrjedhin nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave që të mos kenë mundësitë të tejkalojnë tavanet e financimit në këtë mënyrë duke ruajtur stabilitetin fiskal dhe buxhetore.

Vlerësimi i ndarjes buxhetore për organizatat buxhetore mbështetet në bazë të disa indikatorëve të caktuar ku përfshihen: popullsia, e cila llogaritet (89%), numri i popullsisë pakicë (3%), shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare (2%) dhe përmasat gjeografike (6%).

Mirëpo, përpjekja për të mbajtur nën kontroll organizatat buxhetore edhe në planifikimin e të hyrave vetanake e vështirëson efikasitetin e menaxhimit të parasë publike, si rrjedhojë ka komuna të cilat mund të inkasojnë më shumë të hyra se që janë planifikuara sikur rasti i Komunës së Prishtinës e cila e ka dëshmuar, mirëpo është e përcaktuar dhe në rast që e tejkalon atë kufi atëherë ajo komunë mund t'i nënshtrohet sanksioneve të cilat janë të përcaktuara me ligj.

Qëllimi i kësaj analize është vënia në pah mënyrën se si planifikohen të hyrat vetanake se si bëhet ndarja e buxhetit në kategori, dhe sa arrijnë të realizohen ato të hyra.

Analiza, gjithashtu, është e bazuar në intervistat e përfaqësuesve zyrtarë të komunave që mbulon mënyrën specifike të pjesëmarrjes së tyre në ndarjen buxhetore, përgjegjësitë e bartura si dhe mënyrën e implementimit të udhëzimeve të deleguara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për destinimin e parasë publike në kategori të caktuara, si dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit nga planifikimi e deri të realizimi i të hyrave, realisht për studim kemi përfshirë tre vite 2013, 2014, 2015 duke krahasuar dy vitet e kaluara me vitin aktual.

Të intervistuarit janë pyetur që të përshkruajnë situatat specifike të realizimit të të hyrave vetanake, mënyrën si komunat i inkasojnë të hyrat si dhe kapacitetet nëse mund të bëjnë planifikimin.

Në fund, duhet të vihet re se për studim kemi marrë pesë komuna, duke përfshirë këtu Prishtinën, që është qendra kryesore dhe komuna e cila mund të absorbojë më së shumti të hyra në vend duke krijuar kështu vetqëndrueshmëri financiare, Komuna e Ferizajt e cila është një ndër komunat më të mëdha dhe që ka potencial të lartë sa i përket të hyrave si dhe komunat tjera Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit, që janë komuna të vogla por që kanë krijuar një standard sa i përket inkasimit të të hyrave.

II. Buxheti dhe të hyrat vetanake

Vetqëndrueshmëri financiare është njëri ndër kriteret kryesore për t'u siguruar që niveli lokal, respektivisht komunat të kenë një zhvillim të qëndrueshëm për të krijuar mirëqenie për qytetarët. Në Republikën e Kosovës në bazë të ligjeve në fuqi buxheti rregullohet nga niveli qendror, dhe vetëm disa aspekte të bërjes së buxhetit delegohen në nivelin komunal. Pavarësisht këtyre kufizimeve që burojnë nga legjisllacioni aktual, komunat e Republikës së Kosovës e kanë mundësinë që së paku të hyrat vetanake t'i shpenzojnë sipas nevojës së tyre.

“Komuna dhe zyrtarët e saj ekzekutiv janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë të hyrat komunale dhe grantet operative në të mirë të zgjedhësve të tyre.” (Doracaku i Qeverisjes Lokale)¹

Është më rëndësi të theksohet se qarkoret buxhetore që dërgohen nga Ministria e Financave mund të bëhen pengesë, por rastet e tilla janë të rralla. Pra, në Republikën e Kosovës kemi një sistem të buxhetit më të centralizuar ku niveli qendror është përcaktues si nga aspekti ligjor dhe ai procedural, se si parat publike do të shpenzohen për vitin aktual fiskal.² Nga buxheti i vitit 2015 për Republikën e Kosovës 1.226 miliard janë paraparë të shpenzohen në nivel qendror përderisa 421 milion do t'ju shpërndahen komunave të Republikës së Kosovës për shpenzimet e tyre, 33% është vlera totale e buxhetit që ndahet për mirëqenien e Komunave të Republikës së Kosovës.³ Që krahas linjave tjera buxhetore është më e larta, megjithatë për shkak të nevojave të mëdha kjo shumë është e

¹ Ministria e Pushtetit dhe Administrimit Lokal: Doracaku per qeverisje lokale. I disponueshëm në: <https://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Legjisllacioni/Doracaku-i-Ligjeve-ne-Komuna.aspx> (qasur me datën 14.04.2015).

² Kuvendi i Republikës së Kosovës: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike. I disponueshëm në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L048_al.pdf (qasur me datën 14.04.2015).

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës: Buxheti I vitit 2015. I disponueshëm në linkun: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,1099> (qasur me datën 22.04.2015).

pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha nevojat e komunave të Republikës së Kosovës që në vazhdimësi kërkojnë më shumë investime si nga niveli komunal dhe ai qendror.

Tavanet buxhetore janë tejet strikte dhe nuk mund të shmangen nga komunat gjatë fazës së planifikimit buxhetor. Çdo devijim mund të sanksionohet në mos pranim të buxhetit nga Ministria e Financave⁴ dhe për këtë ministria dërgon në vazhdimësi qarkore buxhetore në komunat e Republikës së Kosovës me kërkesa dhe instruksione të qarta mbi tavanet e buxhetit. Përgjegjësia e vetme e komunave karshi buxhetit përpos planifikimit është inkasimi i të hyrave vetanake dhe përcaktimi i vlerave të të hyrave. Komunat janë drejtpërdrejtë të obliguara që të menaxhojnë dhe të inkasojnë të gjitha ato mjete që rregulloret komunale apo edhe vetë ligjet i parashohin si të taksueshme. Është në diskrecion të komunave të vendosin se për cilat shërbime qytetarët duhet të paguajnë.

Ndërsa, organi vendimmarrës për këto çështje është kuvendi komunal e cila përmes rregulloreve të ndryshme i rregullon format e inkasimit për shërbime komunale.⁵

Në praktikë kjo linjë buxhetore (të hyrat vetanake) ëshë forma e vetme dhe e drejtpërdrejtë e komunave që të krijojnë buxhet për nevoja të cilat nuk arrihen të mbulohen nga buxheti i paraparë nga niveli qendror. Të hyrat vetanake krijohen përmes formave të ndryshme, nga taksat në pronë dhe biznese, taksat për shërbime të ndryshme që ofron komuna, të hyrat nga ndërmarrjet publike që janë në pronësi të komunës, apo të aktiviteteve tjera biznesore që zhvillohen vetë nga ana e Komunës. Në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal komunat e Kosovës caktojnë tarifa të ndryshme, tatime, renta, gjoba dhe bashkëpagesa me qëllim të inkasimit

⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës: Ligji për Financat Publike (mos pranimi i buxhetit). / *disponueshëm në:* http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L048_al.pdf.

⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës: Ligji për Vetëqeverisje Lokale. / *disponueshëm në linkun:* <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530> (qasur me datën 10.04.2015).

të të hyrave vetanake në Komunat e Kosovës.⁶ Deri më tani nuk është vërejtur ndonjë metodë e veçantë për planifikimin e të hyrave vetanake nga ana e Komunave. Për shembull komunat e Republikës së Kosovës bazohen në indikator të përgjithshëm që bazohen në numrin e objekteve banesore dhe biznesore për inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë. Këtu ata bazohen më shumë në të dhënat që kanë komunat nga drejtoritë e urbanizmit. Ndërsa, për inkasimin e të hyrave tjera Komunat shfrytëzojnë të dhënat historike se sa të hyra kishin inkasuar nga shërbimet e ndryshme që kishin ofruar, apo nga marrëveshjet komerciale për qiradhënie, etj. Këtu pastaj përlogaritet edhe rritja potenciale e qytetarëve, bizneseve apo ndonjë indikator tjetër që rezulton në rritjen e të hyrave vetanake.

Në fund këto të dhëna paraqiten nga ekzekutivi i Komunës në propozim buxhetin për vitin përkatës fiskal dhe me planifikimin për vitin e ardhshëm. Duke arsyetuar rritjen apo zvogëlimin e të hyrave vetanake në bazë të indikatorëve që kanë në dispozicion. Për shkak të rrethanave politike dhe të kompetencave që kishin dhe kanë Komunat e Republikës së Kosovës gjatë fazës së hulumtimit nuk është vërejtur ndonjë lidhshmëri në mes të planifikimit të të hyrave vetanake me atë të planeve zhvillimore komunale që kryetarët e Komunavë i hartojnë.⁷ Të hyrat vetanake shpenzohen në të shumtën e rasteve në projekte që nuk kanë kthim të qartë në investim, ose kthimin në investim është vësthirë të llogaritet duke pasur parasysh se paratë e të hyrave vetanake janë shpenzuar për kontrata mbi vepër apo shërbime duke krijuar vende të punës për persona të afërt me qeverinë lokale.⁸ Dhe se kualifikimet e tyre nuk kanë ndonjë veçanti sa që punësimi i tyre mund të konsiderohet strategjike.

Sa i përket të hyrave vetanake Komuna e Prishtinës është e vetmja Komunë në Republikën e Kosovës, që pothuajse në tërësi e bënë


⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. *I disponueshmëm në linkun: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56&lang=sq* (qasur me datën 15.04.2015).

⁷ Planet zhvillimore.

⁸ Numri i kontratave mbi vepër në tri komunat.

planifikimin e të hyrave vetanake për të shpenzuar për investime kapitale. Mbi 40 % e buxhetit të Komunës së Prishtinës vijnë nga të hyrat vetanake dhe se inkasimi i tyre është qenësore për qytetarët e kryeqytetit.⁹ Duke pasur parasysh se grantet qeveritare për kryeqytetin mbulojnë vetëm aspektin e pagave për shëndetësi, arsim dhe stafin e administratës komunale në të shumtën e rasteve, por jo edhe infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar jetën në Kryeqytet.

⁹ Kuvendi Komunal i Prishtinës: Buxheti 2015. *I disponueshëm në linkun:* [https://kk.rks-gov.net/prishtina/Projects/Buxheti-\(1\).aspx](https://kk.rks-gov.net/prishtina/Projects/Buxheti-(1).aspx) (qasur me datën 15.04.2015).



III. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës është komuna më e madhe në Kosovë, jo vetëm nga numri i banorëve por edhe nga aspekti i buxhetit. Si kryeqytet i Kosovës në territorin e Komunës së Prishtinës gravitojnë shumë institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, kjo edhe nxit zhvillimin ekonomik lokal duke u bërë vendi më i preferuar për ndërmarrje të ndryshme që dëshirojnë të zhvillojnë biznesin e tyre. Po ashtu fluksi i madh i qytetarëve që janë zhvendosur në kryeqytet ka nxitur zhvillimin e mëtutjeshëm të Prishtinës nga ana financiare, duke e bërë kështu komunën e vetme që me një pjesë të madhe i vetëfinancon projektet për zhvillimin kapital të Komunës.

Buxheti dhe trendet e të hyrave vetanake

Komuna e Prishtinës si komuna më e madhe në Republikën e Kosovës përfshin buxhetin më të madh se komunat tjera por prap se prap është i pamjaftueshëm në raport me kërkesat dhe nevojat e banorëve duke marre parasysh që është metropol dhe ka lëvizje të qytetarëve edhe nga vendet e tjera. Mirëpo, një karakteristikë që e veçon është se të hyrat vetanake luajnë një rol të rëndësishëm në totalin e buxhetit për komunën në raport me komunat tjera për vet faktin që këto të hyra shfrytëzohen për investime kapitale. Gjatë tre viteve të fundit, shpenzimet buxhetore janë përcjellë me një trend të rritjes relativisht të shpejt, duke arritur vlerën e përgjithshme buxhetore në 200 mil. Euro¹⁰.

Shuma e shpenzimeve buxhetore për vitin 2013 është planifikuar të jetë në vlerë prej 63,371,731 Euro, pjesëmarrja e granteve qeveritare për këtë vit ishte 42,113,811.00 Euro apo 65.66%, kurse 21,757,920 Euro apo

¹⁰ Komuna e Prishtinës: Buxheti 2013,2014 dhe 2015.

I disponueshem ne linkun: [https://kk.rks.gov.net/prishtina/Projects/Buxheti-\(1\).aspx](https://kk.rks.gov.net/prishtina/Projects/Buxheti-(1).aspx) (qasur me daten 10.06.2015).

34.34% të buxhetit e përbënin të hyrat vetanake.¹¹ Ndërsa, të shpenzuara për këtë vit fiskal nga buxheti kanë qenë 68,490,923 euro apo 80.86% duke përfshirë edhe mjetet e bartura nga viti paraprak.¹²

Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake për këtë vit krahasuar me planifikimin komuna ka tejkaluar kufijtë e financimit që ishin përcaktuar në buxhet¹³ duke inkasuar të hyra në vlerë prej 22,061,977.01 Euro apo 101.40%¹⁴, vlera e tejkaluar ishte 304,057.01 Wuro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje mbi 100% të inkasimit duke realizuar normën më të lartë të rritjes vjetore në vitet e fundit.

Në vitin 2014 shuma e shpenzimeve buxhetore ishte planifikuar të jetë 63,443,190.00 euro, grantet qeveritare ishin në vlerë prej 39,124,940.00 Euro apo 61.7%, kurse të hyrat vetanake të planifikuara ishin 24,318,250.00 Euro apo 38.8%.

Vërejmë që për këtë vit ka pas rritje në planifikimin e të hyrave për 4.4%, kurse ulje në grantet qeveritare për 3.96%, ky raport ka reflektuar në rritjen e investimeve kapitale meqë komuna e Prishtinës pjesën më të madhe të të hyrat vetanake i destinon për investime kapitale. Sidoqoftë, komuna e Prishtinës për këtë vit fiskal duke përfshirë edhe mjetet e bartura nga viti paraprak ka arritur buxhetin në vlerë prej 80,782,657 Euro, ku nga ky total 56,738,709 Euro apo 80.86% janë shpenzuar.¹⁵

Si rezultat, gjatë vitit 2014 është arritur vlera e inkasimit të të hyrave në 20,182,489.38 Euro apo 82.99%, ndërsa nuk janë arritur të inkasohen 4,135,760.62 Euro, sa i përket grumbullimit të të hyrave vetanake shumica prej tyre janë inkasuar nga taksa të cilat nuk janë planifikuar e që më tepër ato kanë kontribuar në grumbullimin e të hyrave se sa ato të cilat janë

¹¹Kuvendi Komunal i Prishtinës: Buxheti 2013.

¹²Kuvendi Komunal i Prishtinës: Raporti financiar vjetor 2014 krahasuar me vitin 2013.

¹³ Ministria e Ekonomisë dhe Financave: Qarkorja buxhetore 2013/01. I disponueshëm në linkun: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore> (qasur me datën 12.06.2015)

¹⁴Kuvendi Komunal i Prishtinës: Raporti financiar vjetor 2014 krahasuar me 2013.

¹⁵ Po aty, fq.2

planifikuar. Prandaj, është shumë e rëndësishme të theksohet se të hyrat të cilat planifikohen vështirë se realizohen apo ato të cilat nuk planifikohen realizohen me këtë komuna nuk arrin të parashikoj se ku mund të inkasojë më shumë ose më pak.

Nëse krahasojmë me vitin paraprak në këtë vit komuna nuk ka arritur as kufirin e përcaktuar me buxhet e që mund të jetë shqetësuese për vet faktin që ka shënuar rënie drastike të të hyrave, gjithashtu ia vlen të theksohet se në vitin e kaluar vlera e planifikuar e të hyrave vetanake ka qenë më e ulët kurse është realizuar përtej kufijve të caktuar, ndërsa për këtë vit është më e lartë vlera e planifikuar dhe nuk ka arritur as pragun e caktuar.

Atëherë shtrohet pyetja, se në çfarë parametrash mbështetet Ministria e Financave kur e bën planifikimin e buxhetit, respektivisht të të hyrave vetanake për vitin e ardhshëm, përderisa vërejmë nga një vit në vitin tjetër mosbalancim të planifikimit me realizimin e të hyrave. Mbi të gjitha buxheti vazhdon trendin e rritjes nga viti në vit edhe për vitin 2015 është parashikuar të jetë kjo strukturë e buxhetit.

Sa i përket buxhetit të ndarë për vitin 2015 është planifikuar të jetë 62,114,156.00 Euro, përfshirë grantet qeveritare në vlerë prej 34,951,547.00 Euro apo 56.27%, ndërsa pjesëmarrja e të hyrave vetanake është 43.73% apo në vlerë prej 27,162,609.00 Euro.¹⁶ Vërejmë me këtë që komuna ka shënuar progres sa i përket planifikimit të të hyrave vetanake për këtë vit në raport me grantet qeveritare duke kontribuar në të mirë të komunës.

Sa i përket grumbullimit komuna ka projektuar një plan konkret për këtë vit se si do të realizoj të hyrat vetanake e që nuk dyshojnë se do të ketë ngecje, ku në rast që qytetarët nuk i kryejnë obligimet e tyre të pagesave atëherë ekziston mënyrë e cila praktikohet duke u ndaluar qasje në

¹⁶ Kuvendi Komunal i Prishtinës: Buxheti i miratuar 2015.

I disponueshëm në linkun: [https://kk.rks-gov.net/prishtina/Projects/Buxheti-\(1\).aspx](https://kk.rks-gov.net/prishtina/Projects/Buxheti-(1).aspx) .

shërbimet të cilat i ofron komuna, bllokim të llogarisë, konfiskim të pronës etj.¹⁷

Krahasuar me komunat tjera, pjesëmarrja e të hyrave vetanake në buxhetin total për këtë komunë është gati ekuivalente me grantet qeveritare, e që është një përparësi për këtë komunë për vet faktin që ka potencial të krijoj qëndrueshmëri financiare dhe pavarësi të plotë në planifikimin dhe realizimin e të hyrave.

IV. Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt është njëra ndër komunat më të mëdha të Republikës së Kosovës, në bazë të numrit të banorëve rangohet si e treta në vend me 108,610 banorë.¹⁸ Një numër kaq i madh i qytetarëve është një potencial i mirë për zhvillimin e komunës. Komuna e Ferizajt njihet për prezencën e saj me numër të madh të punëtorëve në kampet ushtarake në Afganistan, Irak dhe në bazën e NATO-së në Bondsteel. Diaspora e kësaj komune gjithashtu konsiderohet njëri ndër kontribuesit kryesor në mirëqenien e Komunës. Sa i përket ndërmarrjeve lokale komuna e Ferizajt ka mbi 5,712 ndërmarrje që zhvillojnë aktivitete të ndryshme biznesore.¹⁹ Një numër kaq i madh i ndërmarrjeve është një potencial i rëndësishëm për Komunën e Ferizajt që të arrij një qëndrueshmëri financiare në afat më të gjatë

¹⁷ Visar Berisha, Drejtor i Financave dhe Pronë, Komuna e Prishtinës (Intervistë), 2015.

¹⁸ Agjencia e statistikave të Kosovës: Në bazë të regjistrimit të popullsisë (2011). *I disponueshëm në linkun: <https://ask.rks-gov.net/popullsia/publikimet-e-statistikave-te-popullsise>* (qasur me datën 03.06.2015).

¹⁹ Agjencia për Regjistrimin të Bizneseve të Kosovës – Llojet e Bizneseve. *I disponueshëm në linkun: http://www.arbk.org/sq/Rezultatet-e-Bizneseve?nb=&eb=&la=&lp=&main_activity=0&other_activity=0&page_b=0* (qasur me datën 03.06.2015).

Buxheti dhe trendet në të hyrat vetanake

Sa i përket buxhetit, Komuna e Ferizajt për shkak të madhësisë së saj dhe numrit të banorëve ajo në tri vitet e fundit mesatarisht ka fituar 19.5 milion euro buxhet vetëm nga grandet qeveritare duke mos përfshirë këtu të hyrat vetanake që kanë shënuar rritje për çdo vit si nga aspekti i planifikimit ashtu dhe nga ai i inkasimit.²⁰

Shuma e shpenzimeve buxhetore për vitin 2013 është planifikuar të jetë në vlerë prej 20,750,262.00 Euro duke shënuar rritje për 4.14% nga viti i kaluar, me pjesëmarrje të granteve qeveritare në vlerë prej 17,124,260.00 Euro apo 82.53%, kurse të hyrat vetanake ishin në vlerë prej 3,626,000.00 Euro apo 17.47%.²¹ Sidoqoftë komuna e Ferizajt për këtë vit fiskal duke përfshirë edhe mjetet e bartura nga viti paraprak ka arritur buxhetin në vlerë prej 22,531,918.76 Euro ku nga buxheti i përgjithshëm 20,762,740.02 Euro janë shpenzuar për kategori të ndryshme komunale.²² Ndërsa, inkasimi i të hyrave vetanake për këtë vit fiskal ka arritur të realizohet në vlerë prej 2,889,199.64 Euro apo 73.59% krahas vlerës së planifikuar në vlerë prej 3,926,000.00 Euro, duke pësuar rënie të vlerës së inkasuar nga viti i kaluar.²³

Në rast se e krahasojmë me planifikimin e të hyrave vetanake në raportin financiar me planifikimin në buxhet, atëherë konstatojmë se është paraqitur shifër më e lartë e planifikimit të të hyrave për inkasim. Në bazë të këtyre shifrave vërejmë mospërputhje të vlerave të planifikuara të të hyrave vetanake në buxhetin e vitit 2013 në raportet financiare për të njëjtin vit dhe me këtë mbetet diskutabile se cili dokument është më i besueshëm dhe në bazë të cilit planifikim kanë realizuar të hyrat për këtë

²⁰ Komuna e Ferizajt: Buxheti 2013, 2014 dhe 2015. *I disponueshëm në linkun:* <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale/Pasqyrat-financiare.aspx> (qasur me datën 04.06.2015).

²¹ Komuna e Ferizajt: Buxheti 2013. *I disponueshëm në linkun:* <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale/Pasqyrat-financiare.aspx> (qasur me datën 04.06.2015).

²² Kuvendi Komunal i Ferizajt: Raporti vjetor i punës për vitin 2013.

²³ Po aty, fq.84.

vit, mirëpo, duhet të merret parasysh se të hyrat e planifikuara në buxhet janë të përcaktuara nga niveli qendror.²⁴

Sidoqoftë, në vitin 2014 është shënuar një trend i rritjes së buxhetit ku shuma e shpenzimeve buxhetore ishte planifikuar të jetë në vlerë prej 23,256,296.00 Euro, duke përfshirë grantet qeveritare në vlerë prej 19,448,996 Euro, kurse të hyrat vetanake 3,807,300.00 € apo 16.37% të buxhetit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin 2013 buxheti për këtë vit ka shënuar ngritje për 10.48%, gjithashtu ka pasur ndryshime pozitive ky buxhet duke u përfshirë këtu edhe të hyrat e bartura nga viti paraprak e që japin vlerën e përgjithshme të buxhetit 26,012,504.18 Euro, kurse janë shpenzuar 24,438,363.13 Euro apo 93.95% nga planifikimi i përgjithshëm i buxhetit.²⁵

Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake krahas planifikimit, Komuna ka inkasuar të hyra në vlerë prej 3,704,800.35 Euro duke shënuar trend negativ në grumbullimin e të hyrave vetanake. Ndërsa, sa i përket zbatimit të planit për inkasimin e të hyrave vetanake Komuna e Ferizajt ka treguar qëndrueshmëri dhe efikasitet deri me një masë të caktuar. Edhe pse në vazhdimësi institucionet komunale kanë arritur t'i inkasojnë deri në masë të 90% e të hyrave vetanake një shumë deri 8 milion euro borxh nga qytetarët është akumuluar gjatë këtyre viteve. Ndërsa Komuna e Ferizajt nuk ka ndonjë plan konkret për inkasimin e këtij borxhi kaq të madh. Vlera e borxhit në 8 milion euro paraqet pothuajse dyfishin e vlerës së planifikuar të të hyrave vetanake nga ana e Komunës së Ferizajt për vitin 2015.²⁶ Përderisa, për vitin 2015 Komuna e Ferizaj ka planifikuar buxhetin e përgjithshëm në vlerë prej 25,659,532 Euro, duke përfshirë grantet qeveritare në vlerë prej 21,454,843 Euro apo 83.61% si dhe të hyrat

²⁴ Ministria e Ekonomisë dhe Financave: Qarkorja buxhetore 2013/01. I disponueshëm në linkun: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore> (qasur me datën 04.06.2015).

²⁵ Kuvendi Komunal i Ferizajt: Raporti vjetor i punës (2014).

²⁶ Lirije Sylja, Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave (intervistë).

vetanake në vlerë prej 4,204,689 Euro apo 16.39 % duke rritur planifikimin e te hyrave për 10.44% krahas vitit të kaluar²⁷.

Vetë Komuna e Ferizajt në dokumentin zyrtar të buxhetit për vitin 2015 konstaton se edhe pse kanë rritje të buxhetit si nga aspekti i granteve qeveritare dhe në atë të hyrave vetanake, ky buxhet është ende i pamjaftueshëm për t'i mbuluar nevojat që kanë qytetarët e kësaj komune. Megjithatë, në raport me grantet qeveritare Komuna e Ferizajt ka filluar që të krijoj një balanc nga të hyrat vetanake nga viti në vit. Sa i përket zbatimit të planit për inkasimin e të hyrave vetanake Komuna e Ferizajt ka treguar fleksibilitet dhe efikasitet deri në një masë të caktuar. Mirëpo, nuk ka ndonjë plan konkret për inkasimin e këtij borxhi kaq të madh. Zakonisht për inkasimin e të hyrave vetanake Komuna e Ferizaj bazohet në disa indikator të rëndësishëm, kryesisht në numrin e pronave dhe bizneseve për tatimin në pronë dhe në parallogaritjen për shërbimet që i ofron duke u bazuar në trendet e viteve më të hershme.²⁸

Deri më tani Komuna e Ferizajt nuk ka hasur në probleme sa i përket realizimit nga stafi i komunës pasi që Komuna i ka kapacitetet e duhura për të bërë inkasimin e të hyrave vetanake duke u bazuar në indikator të qartë dhe të matshëm. Por ajo që është më veçantë për vitin 2015 është se si Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka ndërhyrë në planifikimin e buxhetit duke i kufizuar në mënyrën se si të shpenzohen këto mjete që qartë tregon se ka ndërhyrë në kompetenca që i adresohen vetëm komunës²⁹. Ndërsa, zyrtarët komunal e kanë theksuar si pengesë për të zhvilluar në mënyrë të pavarur të hyrat vetanake që janë një burim i rëndësishëm për komunën e Ferizajt.

²⁷ Kuvendi Komunal i Ferizajt: Propozim-Buxheti 2015. *I disponueshëm në linkun:* <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale/Pasqyrat-financiare.aspx> (qasur me datën 09.06.2015).

²⁸ Po aty, fq.11.

²⁹ Ministria e Ekonomisë dhe Financave: Qarkorja buxhetore 2015/02. *I disponueshëm në linkun:* <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore> (qasur me datën 10.06.2015).

Gjatë hulumtimit nuk kemi arritur që të konstatojmë një lidhje konkrete në mes të Strategjisë së Zhvillimit të Komunës së Ferizajt dhe orientimit të parave të taksapaguesve përmes të hyrave vetanake, në projekte që qartë rezultojnë në kthim në investim.

V. Komuna e Kaçanikut

Si komunë, Kaçaniku ka shumë vështirësi që të siguroj qëndrueshmëri financiare nga të hyrat vetanake. Numri i bizneseve është i ulët duke konsideruar që tregu i kësaj komune ka një potencial të vogël dhe jo shumë tërheqës. Megjithatë, Komuna e Kaçanikut gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë hapa që të siguroj që të hyrat vetanake në këtë komunë të vogël të shtohen dhe se ekonomia lokale të zhvillohet mëtutje. Para se të fokusohemi tek numrat dhe se si janë bërë investimet nga të hyrat vetanake është më rëndësi të theksohen problemet që i ka kjo komunë sa i përket të hyrave vetanake.

Buxheti dhe trendet në të hyrat vetanake

Komuna e Kaçanikut është njëra ndër komunat më të vogla të Kosovës, me një popullsi mbi 33,409 mijë banorë³⁰, potenciali për vetqëndrueshmëri financiare është tejet i vogël. Po ashtu numri i vogël i bizneseve aktive e ka bërë që komuna e Kaçanikut të varet pothuajse plotësisht nga grantet qeveritare dhe ndihmat tjera financiare që vijnë nga niveli qendror apo nga organizatat ndërkombëtare. Për vitin 2014 Qeveria e Kosovës ka investuar në projekte kapitale 2,303,091 milion Euro kryesisht në infrastrukturë rrugore dhe në objekte që përdoren nga institucionet e arsimit. Deri më tani komuna e Kaçanikut ka pasur një buxhet që në tri vitet e fundit

³⁰ Agjencia e statistikave të Kosovës; Në bazë të regjistrimit të popullsisë (2011). / disponueshëm në linkun: <http://ask.rks-gov.net/popullsia/publikimet-e-statistikave-te-popullise> (qasur me datën 03.06.2015).

mesatarisht ka vlerën e 5.3 milion Euro.³¹ Ndërsa mbi 90% e buxhetit buron nga niveli qendror, në bazë të granteve qeveritare që përllogariten me një formulë të veçantë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.³²

Në mungesë të investimeve konkrete komunat e vogla si Komuna e Kaçanikut nuk po arrijnë të krijojnë të hyra vetanake të qëndrueshme nga burimet e tyre. Ndërsa, faktor i rëndësishëm është mënyra se si bëhet planifikimi. Komuna e Kaçanikut fare nuk e bënë planifikimin e të hyrave vetanake, dhe deri më tani nuk ka krijuar ndonjë metodë (plan) me indikator të qartë për ngritjen e të hyrave vetanake, dhe nga viti në vit ky planifikim bëhet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Komuna e Kaçanikut respektivisht, drejtoria që është përgjegjëse për financat nuk janë në dijeni për arsyet se pse dhe për çfarë përqindje bëhet rritja e të hyrave vetanake nga viti në vit. Kështu, Komuna e Kaçanikut sa i përket të hyrave vetanake në planifikim ka bërë rritje në rreth 5% në vazhdimësi. Kështu, që për vitin 2015 është bërë e njëjta gjë nga Komuna e Kaçanikut që vetëm nëse analizojmë rritjen e planifikimit të të hyrave vetanake nga viti në vit shohim se kemi një rritje graduale sa i përket planifikimit. Ndërsa, realizimi në masën 100% deri më tani nuk është arritur nga Komuna e Kaçanikut.

Për vitin 2013 Komuna e Kaçanikut kishte planifikuar që të inkasonte 600,000.00 Euro nga të hyrat vetanake, mirëpo, vetëm 67.5% është arritur që të inkasohet apo 404,000.00 Euro.³³ Ndërsa, për vitin 2014 kemi një rritje sa i përket planifikimit për 30,000.00 Euro ku Komuna e Kaçanikut kishte planifikuar që për atë vit fiskal t'i inkasoj 630,000.00 Euro.³⁴ Ndërsa sfidë vazhdon të jetë inkasimi i të hyrave që kanë qenë të planifikuara më herët.

Për vitin 2014 Komuna e Kaçanikut ka arritur të rrisë inkasimin e të hyrave vetanake deri në 84.71%³⁵, pra për vitin 2014 kjo komunë ka inkasuar 533,

³¹ Kuvendi Komunal i Kaçanikut: Buxheti i vitit 2013,2014 dhe 2015.

³² Po aty.

³³ Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit të Komunës së Kaçanikut (Intervistë).

³⁴ Kuvendi Komunal i Kaçanikut: Buxheti i viti 2014, Kategoria tek të hyrat vetanake.

³⁵ Kuvendi Komunal i Kaçanikut: Raporti financiar(2014).

685.00 Euro që krahas vitit 2013 ka një rritje për 17.21% apo në vlerë prej 129,685.00 Euro. Mirëpo, nga aspekti i planifikimit 96,315.00 Euro nga të hyrat vetanake nuk janë realizuar për vitin 2014.³⁶ Komuna e Kaçanikut në mungesë të investimeve kapitale nga investitorët privat dhe nga investime të kufizuara nga niveli qendror ka zhvilluar politika për nxitjen e bizneseve me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake.

Në komunën e Kaçanikut ata që dëshirojnë të zhvillojnë biznes nuk paguajnë taksa për zhvillimin e biznesit, përjashtim bëjnë këtu bizneset për lojrat e fatit, bankat dhe kompanitë e mëdha si Vala/Posta e Kosovës dhe IPKO. Megjithatë për shkak të tregut të vogël, dhe të investimeve të kufizuara është numër i vogël i ndërmarrjeve që operojnë në këtë komunë. Edhe pse janë të regjistruara 1551 biznese në këtë komunë, 30% e këtyre ndërmarrjeve nuk zhvillojnë aktivitetet biznese fare dhe vetëm janë të regjistruara. Në pamundësi për të rritur të hyrat vetanake nga sektori i biznesit Komuna e Kaçanikut është fokusuar në inkasimin e tatimit në pronë që paraqet burimin kryesor të të hyrave vetanake, dhe kategoria për të cilën më së lehti arrihet zbatimi i planifikimit për të hyrat vetanake. Këtu Komuna e Kaçanikut është siguruar që përmes metodave të ndryshme t'i shtyj qytetarët që së paku tatimin në pronë të paguajnë. Mospagesa e tatimit në pronë mund të rezultoj edhe në mosdhënien e disa shërbime nga Komuna dhe kjo padyshim që ka rezultuar që qytetarët të paguajnë obligimet që kanë ndaj komunës.³⁷

³⁶ Po aty.

³⁷ Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit të Komunës së Kaçanikut (Intervistë).

Bizneset e regjistruara në Komunën e Kaçanikut (31.12.2014)	
Tregëti	466
Transport	334
Ndërtimtari	142
Hoteleri	162
Bujqësi	56
Prodhimtari	186
Zejtari	146
Të tjera	99
Total	1551

Buxheti i Komunës së Kaçanikut krahasuar me vitin e kaluar ka shënuar rritje sa i përket planifikimit të buxhetit në 6,162,677 Euro apo 89.86% e përbërjes së buxhetit total, granti qeveritar është ndarë në vlerë prej 5,464,920 Euro, të hyrat vetanake për këtë vit planifikohen të jenë: 695,757 Euro apo 10.14% e vlerës totale të buxhetit. Krahasuar me vitin paraprak është planifikuar rritje e buxhetit në grantin qeveritar për 10.34%, kurse hyrat vetanake për 10.44%.³⁸

VI. Komuna e Shtimes

Komuna e Shtimes shtrihet në pjesën regjionale të Ferizaj duke përfshirë mesatarisht 27,324 banorë³⁹, që realisht e bën më të vështirë Komunën të realizoj të hyrat në nivel më të lartë, mirëpo në vitet e fundit ka arritur të

³⁸ Kuvendi Komunal i Kaçanikut: Buxheti 2015. *I disponueshëm në linkun:* <https://kk.rks-gov.net/kacanik/Projects/Budget.aspx> (qasur me datën 25.03.2015).

³⁹ Agjensia e statistikave të Kosovës: Në bazë të regjistrimit të popullsisë (2011). *I disponueshëm në linkun:* <http://ask.rks-gov.net/popullsia/publikimet-e-statistikave-te-popullise>, (qasur me datën 03.06.2015).

dëshmojë që mund të siguroj të hyrat deri në një masë të kënaqshme duke shprehur se ka potenciale të realizoj mbi 50% të planifikimit.

Gjithashtu, kjo komunë ka një klimë të favorshme për bizneset të cilat shprehin gadishmërinë të ushtrojnë aktivitetet e tyre prodhuese dhe shërbyese.

Buxheti dhe trendet e të hyrave vetanake

Meqenëse ka numër të vogël të bizneseve kjo komunë burimin kryesor të grumbullimit të të hyrave vetanake e ka nga tatimi në pronë. Në vitin 2013 shuma e përgjithshme buxhetore ishte në vlerë prej 4,786,567.00 Euro, duke përfshirë transferet qeveritare prej 4,396,567.00 Euro apo 91.85%, kurse 390,000.00 Euro kanë qenë të hyrat vetanake apo 8.15% të buxhetit të përgjithshëm.⁴⁰ Vërejmë që transferet qeveritare janë në vlerë shumëfish më të larta se të hyrat vetanake dhe me këtë rast komuna e ka të vështirë të vetëfinancojë projektet e saj komunale.

Sidoqoftë, Komuna e Shtimes për këtë vit fiskal ka arritur të inkasoj 299,305.11 Euro apo 76.75%, kurse 90,694.89 Euro apo 23.25% nuk ka arritur të grumbulloj e që mbetet sfidë për komunën në grumbullimin e tyre⁴¹, mirëpo vërejmë se vlerën më të madhe të të hyrave të planifikuara ka arritur të inkasoj. Ndërsa, në vitin 2014 komuna ka shënuar rritje të buxhetit të planifikuar në total prej 5,360,257.00 Euro, ku transferet qeveritare ishin 4,950,757.00 Euro dhe të hyrat vetanake 409,500.00 Euro⁴², proporcioni në mes të këtyre të hyrave në përqindje qëndron 92.36% me 7.64%, edhe pse në pjesëmarrje kemi rënie të të hyrave vetanake ndërsa rritje të granteve qeveritare prap se prap buxheti i komunës është pasuruar krahas vitit të kaluar. Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake për këtë vit fiskal komuna ka arritur të inkasoj 350,707.12

⁴⁰ Kuvendi Komunal i Shtimes: Buxheti 2013.

I disponueshëm në linkun: <https://kk.rks-gov.net/shtime/Projects/Budget.aspx> (qasur me datën 21.05.2015).

⁴¹ Kuvendi Komunal i Shtimes: Raporti financiar vjetor 2013.

⁴² Kuvendi Komunal i Shtimes: Buxheti 2014.

Euro apo 86%⁴³, me këtë rezultat na bën të kuptojmë që komuna ka kapacitete që këtë trend të inkasimit të të hyrave vetanake mund të arrij edhe në 100%.

Në vitin 2015 shuma e përgjithshme e buxhetit është planifikuar të jetë 5,871,655.00 Euro, ku përfshihen 5,426,152.00 Euro grante qeveritare dhe 445,503.00 Euro të hyrat vetanake ⁴⁴, për këtë vit është parashikuar të rritet inkasimi i të hyrave vetanake, e që paraqet një trend pozitiv dhe tepër të rëndësishëm për komunën.

“Kapacitetet e Komunës për realizimin e të hyrave duke marrë për bazë dy vitet 2013 dhe 2014 dhe inkasimin deri në muajin maj të vitit aktual sillet deri në një mesatare të kënaqshme ku varet edhe nga kufiri i Ministrisë së Financave që e cakton për të hyrat vetanake për secilën komunë”⁴⁵

VII. Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit është një ndër Komunitet më të vogla si për nga sipërfaqja si për nga numri i banorëve. Mirëpo është e rëndësishme të theksohet se shtrirja e saj gjeografike e ndihmon që të zhvillohet më tepër për tregti duke patur parasysh që është në vijën kufitare me shtetin e Maqedonisë dhe mundësitë për t'u zhvilluar në këtë fushë janë të mëdha.

Buxheti dhe trendi i të hyrave vetanake

Komuna e Hanit të Elezit nga viti në vit ka shënuar trend të rritjes në ndarje të shpenzimeve buxhetore, jo vetëm nga grantet qeveritare por edhe në tërheqjen e donacioneve të huaja, ndihmave qeveritare si dhe inkasimin e të hyrave vetanake.

⁴³ Kuvendi Komunal i Shtimes: Raporti financiar vjetor 2014.

⁴⁴ Kuvendi Komunal i Shtimes: Buxheti i miratuar 2015.

⁴⁵ Komuna e Shtimes: Drejtoria e Financave (Intervistë me zyrtaren e Financave).

Në vitin 2014, vetëm nga grantet qeveritare Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të përfitoj mjetet nga financimi qeveritar 1,482,040 Euro, kurse nga të hyrat vetanake 350,000 Euro, si dhe nga përfitimet tjera qeveritare kjo komunë ka arritur buxhetin për vitin 2014 në vlerë prej 2,025,181.18Euro.⁴⁶ Krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje të shpenzimeve buxhetore për 0.6%, ku në vitin 2013 kishte buxhetin në vlerë prej 2,013,149.75 Euro⁴⁷, e që konsiderohet një rritje e mjaftueshme nga viti i kaluar. Ndërsa, sa i përket të hyrave vetanake si për vitin 2013 dhe për vitin 2014 nuk ka pas ndryshim të planit të të hyrave vetanake dhe ka qenë e njëjta vlerë e planifikimit prej 350,000 Euro. Sa i përket realizimit për vitin 2013 komuna ka arritur të realizoj 248,848.46 Euro apo 71.09%, kurse mjetet të cilat nuk janë arritur të grumbullohen për këtë vit arrijnë vlerën deri në 101,151.54 Euro, respektivisht 28.90%.⁴⁸

Gjithsesi, komuna ka arritur të inkasoj të hyra mbi mesataren vjetore. Në buxhetin e vitin 2014 gjithsej të hyrat e planifikuar për këtë vit kemi 350,000 Euro, ku komuna ka arritur të grumbulloj 277,233.12 Euro apo 79.21%, kurse nuk ka arritur të grumbulloj vetëm 72,766.88 Euro apo 20.80%, nga kjo kuptojmë që pavarësisht se nuk ka arritur kufirin e përcaktuar në vlerë prej 350,000Euro për këtë vit prap se prap krahasuar me vitin parakrak komuna ka arritur të shënoj progres sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake për 28,384.66 Euro apo 11.41% dhe e bën të qartë se kjo komunë mund dhe ka kapacitete të mjaftueshme në inkasimin e të hyrave vetanake.

Sa i përket buxhetit të vitit 2015 komunës së Hanit të Elezit i është ndarë buxhet në vlerë prej 2,051,844 Euro ku janë planifikuar grantet qeveritare të jenë në vlerë prej 1,795,586Euro, kurse të hyrat vetanake 256,258 apo

⁴⁶ Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit: Raporti financiar vjetor 2014. *I disponueshëm në linkun: <https://kk.rks-gov.net/hanielezit/Projects/Budget.aspx>* (qasur me datën 01.05.2015).

⁴⁷ Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit: Raporti financiar vjetor 2013. *I disponueshëm në linkun: <https://kk.rks-gov.net/hanielezit/Projects/Budget.aspx>* (qasur me datën 04.05.2015).

⁴⁸ Po aty, fq.4.

12.48 % të buxhetit në total, nga ky planifikim vërejmë që krahasuar me vitet e kaluara për këtë vit është planifikuar rritje e grantit qeveritar, mirëpo ulje në të hyrat vetanake për 93,742 Euro.⁴⁹ Realisht nga viti i kaluar për këtë vit kemi rritje të vlerës totale për 2,666,282 Euro. Nga kjo vijmë në përfundim se komuna për dy vite radhazi ka pas të njëjtin planifikim në të hyra vetanake, pastaj kur në vitin 2014 krahas vitit 2013 ka rritur inkasimin, për vitin 2015 ka pas rënie në planifikim, në kohën kur ka filluar të shënoj rritje të realizimit i janë shkurtuar të hyrat vetanake të planifikuara.

VIII. Përfundimet

Niveli qendror bën planifikimin se sa duhet të inkasoj një komunë duke u mbështetur në disa parametra fiks dhe që komunat nuk janë të informuara se si bëhet kjo ndarje dhe vetëm i ndjekin udhëzimet e Ministrisë përmes qarkoreve buxhetore.

1. Niveli i ulët i bashkëpunimit në mes të institucioneve qendrore me ato lokale e që vazhdon të jetë pengesë në rritjen e efijencës në alokimin dhe përdorimin e të hyrave komunale.
2. Komunat vazhdojnë të realizojnë të hyrat nën presion e që në raste vie deri te rënia e menaxhimit të efijencës dhe përdorimi i parasë publike në mënyrë transparente.
3. Rënia e të hyrave në disa komuna ka rezultuar si pasojë e disa faktorëve si:
 - a) Numri i vogël i banorëve,
 - b) Numri i vogël i ndërmarrjeve që zhvillojnë aktivitetet biznesore
 - c) Mungesa e investimeve nga investitorët potencial,

⁴⁹ Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit: Buxheti i miratuar 2015. *I disponueshëm në linkun: <https://kk.rks.gov.net/hanielezit/Projects/Budget.aspx>* (qasur me datën 04.05.2015).

- d) Emigrimi dhe papunësia (konstatim nga Komunitat) ka ndikuar në uljen e të hyrave vetanake pasi që qytetarët nuk kanë mundësi që të paguajnë obligimet.

4. Ndarja e buxhetit vazhdon të bëhet mbi të dhënat e popullsisë të vitit 2011 e që është diferencë e lartë me vitet aktuale dhe mund të sjellë një situatë ku nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë joreale konform ndarjes buxhetore dhe bien ndesh me parimin e subsidiaritetit në qeverisje lokale ku të gjitha vendimet duhet të jenë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

5. Komunitat nuk kanë ndonjë strategji të veçantë për të adresuar rritjen e të hyrave vetanake apo ngritjen e kapaciteteve për akumulimin e të hyrave vetanake meqë janë të fokusuar vetëm në zbatimin e projeksioneve që vijnë nga niveli qendror.

6. Në komunitat e vogla dhe të mesme shpenzimet komunale janë përqëndruara në mirëmbajtjen e administratës publike e cila është e stërngarkuar nga nepotizmi dhe ndërhyrjet politike, pra krijimi i vendeve të punës është fokusuar në administratë publike e jo në tregun e lirë përmes investimeve dhe subvencioneve.

7. Si rrjedhojë, në projeksionet buxhetore rritjet e pagave vetëm në sektorin e arsimit konsiderohet se janë rritur me ritme të larta se në sektorët e tjerë, ndërsa nuk kemi rritje të performancës nga personeli i arsimit.

8. Përcaktimet e kufijve të financimit si dhe mënyrën se si të shpenzohen ato të hyra i bën komunitat që të heqin dorë nga shumë prioritete të planifikuara.

9. Komunitat nuk arrijnë gjithmonë inkasimin e të hyrave vetanake sa është planifikuar për arsye se:

- a) Komunitat nuk i njohin indikatorët mbi të cilat Ministria i parasheh të hyrat vetanake të paktën komunitat e vogla,

- b) Pas deklaratës së faljes së borxheve nga qeveria qytetarët nuk po i paguajnë obligimet. (Në Kaçanik dhe Prishtinë është e konfirmuar),
- c) Të hyrat vetanake nuk destinohen për investime kapitale, por shpenzohen në kategori që nuk sjellin kthim në investim,
- d) Këtu bëjnë pjesë edhe shumë kontrata mbi vepër që mundësojnë komunat që të punësojnë militant.

10. Përderisa komunat nuk kanë strategji të qartë për të mbështetur ekonominë lokale për hapjen e vendeve reja të punës vetë qëndrueshmëria financiare nuk mund të arrihet për një kohë të gjatë pasi që deri më tani Komunitat janë shpenzuesit më të mëdhenj të parave të taksapaguesve se sa kontribues.

IX. Rekomandimet

Për një qeverisje të mirë dhe më afër qytetarëve preferohet që të kenë qeverisjet lokale autonomi më të lartë në ushtrimin e kompetencave financiare.

A. Për Komunitat:

1. Të rritet përgjegjësia e qeverisjes lokale, në mënyrë që të rritet efikasiteti i tyre dhe në këtë mënyrë do të jenë më pranë kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, por sigurisht duke mos e përjashtuar mundësinë për konsultim me nivelin qendror.
2. Komunitat duhet të hartojnë sa më shpejtë Planin për rritjen e të hyrave vetanake, së bashku me Strategjinë e detajuar për rritjen e të hyrave vetanake.
3. Komunitat të kenë kompetenca që në mënyrë të pavarur të bëjnë planifikimin e të hyrave vetanake në bazë të kritereve të cilat ata i shohin si të arsyeshme dhe të arritshme për t'u realizuar, me këtë

rast mund të ushtrojnë një shkallë më të lartë të mbikqyrjes mbi mënyrën se si kryhen detyrat.

4. Shërbimet në investime lokale të financohen deri në një masë të konsiderueshme nga të hyrat vetanake e jo nga grantet qeveritare.
5. Krijimi i strukturave të përshtatshme të menaxhimit në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të personelit në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët si dhe ngritjen e nivelit të përgjegjësisë së qytetarëve ndaj obligimeve.
6. Komunitat të kenë mundësinë të përpilojnë një strategji të qartë me fokus të veçantë në zhvillimin ekonomik lokal dhe në hapjen e vendeve të reja punës.
7. Grumbullimi i të hyrave vetanake të planifikuara të jenë të arritshme dhe reale në mënyrë që inkasimi i tyre të jetë konform planifikimit dhe jo të ketë diskrepancë në mes të planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetanake.

B. Për Ministrinë e Financave:

- 1) Niveli qendror të ketë parasysh edhe potencialet e zhvillimit ekonomik me karakter rural të asaj komune kur të trajton çështjen e të hyrave vetanake.
- 2) Të lejoj shkallë të lartë të pavarësisë së Komunave në Planifikimin e të hyrave vetanake.



INICIATIVA PËR PROGRES - INPO
RRUGA "AHMET KAÇIKU" | FERIZAJ, 70000 KOSOVË
RRUGA "REXHEP LUCI" | PRISHTINË, 10000 KOSOVË
TEL: +381 (0) 38 220 552 | +381 (0) 290 329 400
WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG